



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 160 prot.

Kamëz, më 18 . 12 . 2023

V E N D I M

Nr 15 Datë 18/12/2023

P Ë R

“MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE QË JANË REKOMANDUAR NGA  
ADMINISTRATORET SHOQËRORË PËR TRAJTIM ME FONDIN 6% TË BLOK-  
NDIHMËS EKONOMIKE”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 18.12.2023, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.84 Datë 13.12.2023, mbështetur në Ligjin 57. Date 18.07.2019 “Mbi Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” neni 21, VKM – në nr.956, datë 07.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të detajeve të formulës së unifikuar të pikëzimit për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe shërbimet shoqërore” Kreu IV, pika 2 të Vendimit nr. 955 datë 07.12.2016, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike” të ndryshuar dhe Udhëzimit nr.5, datë 17.02.2017 “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%” të ndryshuar kreu IV, pika 3, Vendim 868, datë 29.12.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.597 date 04.09.2019 dhe në VKB nr. 04 datë 23.01.2023 “Mbi miratimin e kriterëve për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet që nuk janë përfituese nga sistemi i pikëzimit”, Këshilli Bashkiak Kamëz;

V E N D O S I :

1. Miratimin e listës së muajit Nëntor 2023, prej 71 familje që janë rekomanduar nga administratoret shoqëror për fondin 6% të bllok-ndihmës ekonomike.  
Fondi për këto familje është 381,784 (treqind e tetëdhjetë e njëmijë e shtatëqind e tetëdhjetë e katër) lekë.
2. Lista e familjeve të cituara në pikën 1 të këtij vendimi paraqitet në relacionin bashkëlidhur dhe është pjesë e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

KRYETAR KËSHILLI

Hysen KOLDASHI

